

URDHËR
Nr. 155, datë 9.6.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për procedurat e prokurimit me të ardhurat dytësore dhe financimet e tjera, në Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, zv.drejtorit Ekonomik/Administrativ, znj. Arta Hajro.
2. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.
3. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri të gjithë sektorët/personat përgjegjës për prokurimin.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Eliona Demaliaj